



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:043213

Datë: 04.02.2019

Numri i dokumentit: 00218352

P. nr.502/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Iirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit N. J. nga Peja, për shkak të veprës penale të vjedhjes nga neni 325 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore- DP në Gjakovë, PP.nr.911/18 të datës 17.07.2018, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **21.01.2019**, në prani të Prokurorit të shtetit Ismet Tofaj, të dëmtuarës A. D. si dhe të akuzuarit N. J., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **N. J.** nga Peja, „Rr” ... ” nr...., i biri i Q. dhe i nënës Gj. e gjinisë Z. ,data e lindjes ... në Pejë, ka të kryer shkollën fillore, punëtor fizik-rast social, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i martuar at i 2 fëmijëve, nr. ID

Ë s h t ë f a j t o r:

Sepse:

-me dt. 17.04.2018,rreth orës 12.15 min, në Gjakovë, ne rrugën “...”me qellim të përvetësimit të kundërligjshme për veti apo për tjetrin, i merr pasurinë e luajtshme tjetrit, të dëmtuarës A. S. D. nga Gjakova, Rr. “ “ nr. ..., i vjedh biçikletën me ngjyrë të bardhë cila ka vlerën diku 140 euro, ne atë mënyrë që shkon tek hyrja e banesës e cila gjenet pas kafiqave, afër Ordinancës Stomatologjike “Sh. D.”, e kur e verën biçikletën të mbështetur në hyrje të ndërtesës e vjedh e me të largohet në drejtim të pa ditur dhe e dërgon në Pejë dhe në treg e shet për 25 euro.

- me çka ka kryer veprë penale të vjedhjes nga neni 325 par. 1 të KPRK-së

Andaj Gjykata në bazë të nenit 4,41,43,49,50,51,52.5,73 të KPRK-ës, dhe nenit 325/1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarit N. J. i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej **6(gjashtë)muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 2 (dy)vite, nuk kryen

ndonjë vepër tjetër penale dhe dënim me gjobë ne shumë prej 100(njëqind) euro, të cilin shumë obligohen që ta paguajnë në afat prej 1(një) muaji , pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë .

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajnë gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPPK-ës, dënimi me gjobë do t'i zëvendësoi me dënim burgu në kohëzgjatje prej nga 5 (pesë) ditësh, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga 20.00-€.(njëzet) euro, të gjobës.

Shpenzimet e procedurës penale bien ne barrën e mjeteve buxhetore te gjykatës.

Mbikëqyrjen e periudhës verifikuese te dënimit me kusht do ta bënë Shërbimi Sprovues i Kosovës Zyra Regjionale në Gjakovë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.911/18 të datës 17.07.2018 , e ka akuzuar të akuzuarin N. J. nga Peja , për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325/1 të KPRK-së,

Gjatë shqyrtimit fillestar të datës 21.01.2019, përfaqësuesi i PTH-së në Gjakovë , Prokurori Ismet Tofaj , pasi lexon aktakuzën PP .nr. 911/18 të dt. 17.07.2018 deklaroi se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës .

I akuzuari N. J. në shqyrtimin fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon ne tersi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion shtojë se është me pranimin e fajësisë ne çdo fazë te procedurës është penduar për veprën e kryer për shkak te kushteve te dobëta ekonomike , me qe jam i pa punë dhe rast social ,kërkojë falje nga te dëmtuarit për demin e shkaktuar , premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet andaj i propozoi gjykatës qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë , gjendjen e varfër ekonomike –shfrytëzues i ndihmave sociale, gjendjen shëndetësore për te cilën prezantojë edhe raportet e mjekut, jam mbajtës i vetëm i familjes prej 4 anëtarësh , premtimi se ne te ardhmen do te jem me i kujdesshëm te me shqiptojë një dënim me te butë.

E dëmtuara A. D. deklaroi se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkojë kompensim demi .

Duke u deklaruar lidhur me fajësinë Prokurori i shtetit Enis Gashi , deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi qe i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favoret juridike te pranimi te fajësisë dhe se aktakuza ka mbështetje ne prova dhe shkresat e lendes..

Ne shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

-Ne tërësi u vërtetua se i akuzuari N. J. : në Gjakovë ,në rrugën “... ”me qellim te përvetësimit te kundërligjshme për veti apo për tjetrin ,i merr pasurinë e luajtshme tjetrit, të dëmtuarës A. S. D. nga Gjakova, Rr. “ ... “ nr., i vjedh biçikletën me ngjyrë të bardhë cila ka vlerën diku 140 euro , ne atë mënyrë qe shkon tek hyrja e banesës e cila gjenet pas kafiqave, afër Ordinancës Stomatologjikë “Sh. D.” , e kur e verën biçikletën te mbështetur në hyrje te ndërtesës e vjedh e me te largohet ne drejtim te pa ditur dhe e dërgon ne Pejë dhe në treg e shet për 25 euro.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimit te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë ,pranimi është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza ,ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarin ta shpalle fajtor dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarit ,gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit .Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e vullnetshme te fajësisë nga i akuzuari ne çdo fazë te procedurës , gjendjen e dobët ekonomike-shfrytëzues i ndihmave sociale , baba i katër fëmijëve ,mbajtës i vetëm i familjes, pendimin e tij , sjelljen korrekte në gjykim , kërkim falja nga i dëmtuara për dëmin e shkaktuar , premtimi se ne te ardhmen nuk do te kryej vepra te tilla, deklarimi i të dëmtuarës se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim dëmi . Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënim me burgu në kohëzgjatje prej 6(gjashtë)muajve ,i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 2 (dy)vite, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale dhe dënim me gjobë ne shumë prej 100(dyqind) euro, të cilin shumë obligohen që ta paguajnë në afat prej 1(një) muaji , pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbartimit me dhunë , do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Gjykata nuk ka vendosur për kërkesën pasurore juridike ngase e dëmtuara, gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike.

Vendimi që shpenzimet e procedurës penale të bien ne barrën e mjeteve buxhetore, gjykata e morri ne mbështetje te nenit 453/4 te KPP-ës , pasi qe i akuzuari është shfrytëzues i ndihmave sociale e detyrimi qe ti paguajnë shpenzimet procedurale do te rrezikonte gjendjen materiale te akuzuarit ose të personave që ajo detyrohet ti mbështes .

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.502/18 më datë 21.01.2019**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit ne Prishtinë. Ankesa ne kopje te mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:043213
Datë: 04.02.2019
Numri i dokumentit: 00218352